

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtari individual Elmaz Zenuni, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Gazmend Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurve: 1. [REDACTED] nga [REDACTED], Rruga [REDACTED] nr. [REDACTED] të cilin sipas detyrës zyrtare e përfaqëson av. [REDACTED] dhe 2. [REDACTED] nga [REDACTED] Rruga [REDACTED] nr. [REDACTED] të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati [REDACTED], për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vjedhja e rëndë nga neni 327 par. 1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kurse i pandehuri i parë [REDACTED] edhe për veprat penale dhe ato : shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 410 par.1 të KPRK-së dhe rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH –së në Ferizaj PP/II nr.15-4/2018 të datës 20.02.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor publik me datën 22.03.2018, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Valdet Avdiu të pandehurve me mbrojtësit e tyre, të njejtën ditë më 22.03.2018, mori dhe publikisht komunikoi këtë:

**A K T G J Y K I M**

Të akuzuarit:

1. [REDACTED] nga [REDACTED], Rruga [REDACTED] nr. [REDACTED] i lindur më [REDACTED] në [REDACTED] i njohur me nofkën [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] i martuar baba i 1(një) fëmie, me profesion automekanik, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme të ndërtimtarisë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në Praburgim prej datës 03.01.2018, i cili paraburgim zgjati deri më 22.03.2018.

2. 2. [REDACTED] nga [REDACTED] Rruga" [REDACTED] nr. [REDACTED] i lindur më [REDACTED] në Prishtinë i njohur me nofkën [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme të informatikës, me profesion saldues, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në Praburgim prej datës 03.01.2018, i cili paraburgim zgjati deri më 22.03.2018.

Të pandehurit: 1. [REDACTED] dhe 2. [REDACTED]

### JANË FAJTORË

*Sepse:*

- I. me datën 29.12.2017 rreth ores 12:35 në Rrugën "Rexhep Bislimi", përkatësisht në parkingun e Qedrës Tregtare "EL-i AB" në Ferizaj, të pandehurit pas një marrëveshje paraprake dhe një plani të organizuar mire me qëllim që me përvetësimin të kundërligjshëm të pasurisë të tjetrit, në atë mënyrë që duke përdorur forcën me anë të një kaqavide e kanë thyer xhamin e dritarës së pasme të anës së djathtë të veturës e markës "BMW X 5" me targa të regjistrimit [REDACTED], pronë e të dëmtuarit [REDACTED] dhe nga ulësja e pasme kanë marrur çantën krahut të femrave, ku sipas të dëmtuarës i kanë shkaktuar dëm material në vlerë rreth 200 eurove,-

Me të cilën në bashkëkryerje të pandehurit: 1. [REDACTED] dhe 2. [REDACTED] kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 nënpar.1.1 të KPRK-së.

II. I pandehuri i parë : [REDACTED]

1. Më datën 29.12.2017, rreth ores 17:00 në Rrugën "Vllëzërit Gërvalla" në Ferizaj i pandehuri me veturën e markës "VW Golf" me targa të regjistrimit [REDACTED] ka shkaktuar rrezik të madhë për jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që deri sa ishte duke ikur nga policia ka drejtuar automjetin në mënyrë shumë të rrezikshme duke e goditur fillimisht

autpomjetin zyrtar të policisë e pastaj edhe dhjetë automjete tjera të cilat disa prej tyre ishin në lëvizje e disa të parkuara, duke shkaktuar rrezik të madhë për jetën e njerëzve në rrugë dhe trotuar , nga se e njejta rrugë frerkuentohet mjaft shumë, me ç,rast ka shkaktuar dëmë të konsiderueshëm material si dhe lëndime trupore ka pësuar i dëmtuari [REDACTED] drejtues i automjetit “Opel Vectra” me targa të regjistrimit [REDACTED]

*me të cilën kreu veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së,*

2. Me datën 29.12.2017 në Rrugën “Vllëzërit Gërvalla” në Ferizaj i pandehuri në parkingun e marketit “Super Viva” me dashje ka sulmuar personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare dhe ate zyrtarët policor [REDACTED] dhe [REDACTED] [REDACTED], të cilët e kishin parkuar veturën pranë veturs së të pandehurve, zyrtari policor [REDACTED] ishte ofruar për të i legjitimuar në atë moment i pandehuri [REDACTED] me vrullë e nis veturën e tij në drejtim të policit duke e rezikuar ate, pastaj lëviz prapa dhe niset në drejtim të veturës së policisë kun-ë veturë ishin policët duke i goditur në pjesën e përparme të anës së majtë dhe largohe nga aty,-

*me të cilën kreu veprën penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par.1 të KPRK-së,*

3. Me datën 29.12.2017 rreth ores 17:00 në Rrugën “Vllëzërit Gërvalla” në Ferizaj i pandehuri, duke drejtuar automjetin e markës “ VW Golf” me targa të regjistrimit [REDACTED] ka rrezikuar trafikun publik duke rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre,ashtu që me dashje ka drejtuar automjetin në mënyrë të rrezikshme ku deri sa ishte në ndjekje nga policia ka goditur automjetin e markës “Shkoda” me targa të regjistrimit të policisë [REDACTED] pronë e policisë së Kosovës ,automjetin e markës “Opel” me targa të regjistrimit [REDACTED] pronë e [REDACTED] , automjetin e markës “Daimler” me targa të rgjistrimit [REDACTED] pronë e [REDACTED] ,

automjetin e markës "Mercedes" me targa të regjistrimit [REDAKTUAR]  
 automjetin e markës " VW Golf" me targa të regjistrimit [REDAKTUAR] pronë e [REDAKTUAR],  
 automjetin e markës " Audi" me targa të regjistrimit [REDAKTUAR],  
 pronë e [REDAKTUAR], automjetin e markës "Daimler" me targa të regjistrimit [REDAKTUAR],  
 pronë e [REDAKTUAR], automjetin e markës " Audi" me targa të regjistrimit [REDAKTUAR] pronë e [REDAKTUAR],  
 automjetin e markës " VW Golf" me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], pronë e [REDAKTUAR]  
 automjetin e markës "Opel Vectra" me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], pronë e [REDAKTUAR],  
 ku përveç dëmeve material lëndime të lehta trrupore pëson edhe [REDAKTUAR] të përshkuara në Ekspertizën Mjeko-ligjore të dt.11.01.2018 të cilat lëndime rezultojnë me dëmtime të përkohëshme të shëndetit,-

*me të cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.1 të KPRK-së,*

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave ligjore të sipërtheksuara dhe nenit 4, 7, 17, 21, 31, 41, 43, 45, 46, 73 dhe nenit 80 e 83 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të akuzuarit i:

## G J Y K O N

**I Pandehuri i parë:** [REDAKTUAR]

Për pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi për veprën penale në bashkëkryerje me të të pandehurin [REDAKTUAR] dhe ate vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 nënpar.1.1 të KPRK-së, **DENOHET**

Me denim me gjobë në lartësi prej 1.000 euro (me shkronja:njëmijë euro), si dhe denimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim, i cili do të ekzekutohet nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

Për pikën II. pika 1. të dispozitivit të këtij aktgjykimi për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së DENOHET :

Me denim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet burgim, i cili do të ekzekutohet nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

Për pikën II. pika 2. të dispozitivit të këtij aktgjykimi sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par.1 të KPRK-së, DENOHET:

Me denim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj burgim, i cili do të ekzekutohet nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

Për pikën II. pika 3. të dispozitivit të këtij aktgjykimi rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.1 të KPRK-së, DENOHET :

Me denim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj burgim, i cili do të ekzekutohet nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 80 të KPRK-së, të pandehurit të parë [REDAKTUAR] i shqiptohet DENIMI UNIK dhe ate DENIMI ME BURG në kohëzgjatje prej 4 vjet burgim dhe DENIMI ME GJOBË në shumën prej 1.000 euro (me shkronja: një mijë euro).

Në denimin e shqiptuar konform nenit 83 të KPRK-së i llogaritet edhe koha e kaluar në parapurgim prej datës 03.01.2018 deri më 22.03.2018.

Nëse dënimi me gjobë pjesa denuese prej 1.000 euro nuk mund të ekzekutohet asë në mënyrat tjera të parapara nga neni 46 par.3 të KPRK-së, gjykata do ta ekzekutoj aktgjykimin në atë mënyrë që i pandehuri për çdo 20 € të gjobës të vuaj një ditë burgu.

I Pandehuri i dytë: [REDAKTUAR]

Për pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi për veprën penale në bashkëkryerje me të të pandehurin [REDAKTUAR] dhe ate vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 nënpar.1.1 të KPRK-së DENOHET:

Me denim me gjobë në lartësi prej 1.000 euro (me shkronja: një mijë euro), si dhe denimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim, i cili do të ekzekutohet nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

Në denimin e shqiptuar konform nenit 83 të KPPRK-së i llogaritet edhe koha e kaluar në parapurgim prej datës 03.01.2018 e deri më datën 22.03.2018.

Nëse dënimi me gjobë e shqiptuar për secilin të pandehur veq e veq pjesa denuese prej nga 1.000 euro nuk mund të ekzekutohet asë në mënyrat tjera të parapara nga neni 46 par.3 të KPRK-së, gjykata do ta ekzekutoj aktgjykimin në atë mënyrë që të pandehurve secilit veq e veq për çdo 20 € të gjobës të vuajnë nga 1 (një) ditë burgu.

Të dëmtuarit: 1. [REDAKTUAR], 2. [REDAKTUAR], që të dy zyrtar policor në Stacionin e Policisë në Ferizaj, 3. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Kaçanikut, 4. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, 5. [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr. 6. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, 7. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Kaçanikut, 8. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, 9. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, 10. [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR]” pa nr. dhe 11 [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR]” nr [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesë pasurore- juridike kompensimi i dëmit udhëzohen në kontest civil.

Të pandehurit 1. [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], obligohen secili veq e veq që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 30 €, kurse i pandehuri i parë [REDAKTUAR] edhe shpenzimet e procedurës penale në lartësi prej 20 eurove në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin të përmbarimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohen të akuzuarit 1. [REDAKTUAR] dhe 2. [REDAKTUAR] secili veq e veq që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguajnë shumën prej nga 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën e vetë PP/II nr.15-4/18 dt. 20.02.2018 ka akuzuar të pandehurit: 1. [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] Rruga [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR], të cilin sipas detyrës zyrtare e përfaqëson av. [REDAKTUAR] dhe 2. [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], Rruga [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR], të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vjedhja e rëndë nga neni 327 par. 1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kurse i pandehuri i parë [REDAKTUAR] edhe për veprat penale dhe ate : shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 410 par.1 të KPRK-së dhe rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.1 të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar sipas kësaj aktakuze konform nenit 245 të KPPRK-së, me dt.22.03.2018 ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar gjyqësor, në të cilin ka marrur pjesë Prokurori i shtetit Valdet Avdiu dhe të pandehurit me mbrojtësit e tyre dhe ate për të pandehurin e parë [REDAKTUAR] të cilin sipas detyrës zyrtare e përfaqëson av. [REDAKTUAR] e tij dhe të pandehurin e dytë [REDAKTUAR] sipas autoirizimit e përfaqëson Av. [REDAKTUAR] ashtu që sipas nenit 245 par.4 të KPPRK-së, Gjyqtari gjykues është siguruar se prokurori i shtetit para shqyrtimit të dytë i ka përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave sipas nenit 244 të KPPRK-së.

Të pandehurit pasi që janë udhëzuar nga ana e Gjyqtari Gjykues sipas nenit 246 të KPPRK-së, ashtu që konform nenit 248 par.5 të KPPRK-së, iu është dhënë mundësia që edhe në këtë fazë të procedurës, pra të shqyrtimit fillestar gjyqësor të pandehurit të pranojnë fajsinë ose të deklarohet të pa fajshëm.

Të pandehurit: 1. [REDAKTUAR] dhe 2. [REDAKTUAR] në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 22.03.2018, pas këshiillimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre Av. [REDAKTUAR] dhe Av. [REDAKTUAR], që të dy njëkohësisht i ka pranuar veprat penale për të gjitha pikat e aktakuzës për të cilën akuzohen, pasi që janë udhëzuar nga ana e Gjyqtarit gjykues

konform nenit 248 par.5 të KPPRK-së, se të pandehurit janë deklaruar fajtorë për veprat penale për të gjitha pikat e aktakuzës në pikën I. dhe II. nën-pikat 1, 2 dhe 3 të këtij aktgjykimi, për të cilën e ngarkon akuza, duke shprehur pendimin e thellë për veprat penale të kryera, rrethanat familjare kanë diktuar që ai ta bëjnë këtë veprim, si dhe i kanë premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra tjera penale, asnjëherë më parë nuk kanë qenë të denuar dhe i propozojnë gjykatës që të iu shqiptohet një denim sa më të butë.

Me mendimin e të akuzuarave përkitazi me pranimin e fajsisë janë pajtuar edhe mbrojtësit e të akuzuarve dhe atë: Av. [REDAKTUAR] dhe Av. [REDAKTUAR] duke i propozuar gjykatës që të merr për bazë rrethanat posaçërisht lehtësuese rreth shqiptimit të denimit duke aplikuar edhe nenin 75 të KPRK-së.

Mbrojtësit e të akuzuarve secili njejt kanë shtuar se i mbrojturi i tij asnjë herë nuk ka ra ndesh me ligjin, është hera e parë që përgjigjet për vepër penale, ka premtime të thella, por edhe krahas pendimit se në të ardhmen kurr nuk do të përsëris vepër penale dhe kanë propozuar gjykatës që për të mbrojturit e tyre të shqiptohet një denim sa më i butë.

Gjyqtari gjykues konform nenit 248 par.1 të KPPRK-së, por edhe nenit 75 par.3 të KPRK-së, në vlerësimin e pranimit të fajsisë ka marrur mendimin e prokurorit të shtetit, mbrojtësve të të akuzuarve, të cilët kanë vlerësuar dhe janë pajtuar me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarve dhe kanë theksuar se duhet t'i pranohet fajësia me që ky pranim mbështet në faktet e çështjes penale që përmban akuza dhe konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së gjykata ka aprovuar pranimin e fajsisë, ashtu siq paraqitet në akatakuzën e prokurorisë.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar gjyqësor, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

- Të pandehurit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë,
- Pranimi është bërë vullnetarisht,

- Pranimi mbështetet në prova dhe fakte të çështjes penale që përmban aktakuza dhe materialet e prezentuara nga ana e prokurorit të shtetit me aktakuzë dhe ate: Deklaratat e të dëmturve dhe ate: 1. [REDAKTUAR], 2. [REDAKTUAR] që të dy zyrtar policor në Stacionin e Policisë në Ferizaj, 3. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Kaçanikut, 4. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, 5. [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga "[REDAKTUAR]" pa nr., 6. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, 7. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Kaçanikut, 8. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, 9. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, 10. [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga "[REDAKTUAR]" pa nr. dhe 11. [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga "[REDAKTUAR]" nr. [REDAKTUAR] dhe në procedurën paraprake, Ekspertiza mjeko-ligjore e dt.11.01.2018, fotografitë dhe shkresat tjera të lëndës, të cilat janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës,
- akuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike, njashtu të akuzuarit janë udhëzuar nga ana e Gjyqtarit gjykues edhe konform nenit 383 par.2 të KPPRK-së, përkitazi me të drejtën e ankesës vetëm për sanksionin penal, por jo edhe për shkak të gjendjes faktike, si dhe
- Konform nenit 257 të KPPRK-së, aktakuza nuk ka prova të pa pranuesheme.

Mbrojtësit e të akuzuarve Av. [REDAKTUAR] dhe Av. [REDAKTUAR] në shqyrtimin fillestar gjyqësor janë pajtuar me pranimin e fajsisë nga ana e të mbrojturve të tyre, por i kanë propozuar gjykatës që gjatë matjes së denimit gjykata të ketë parasysh në veçanti pranimin e fajsisë nga ana e të pandehurve dhe sjellja korrekte dhe të sinqert nga ana e tyre gjatë pranimit të veprave penale të cilat u vëhet në barrë.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit të parë [REDAKTUAR] së bashku me të akuzuarin e dytë [REDAKTUAR] përmbushen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprave penale në bashkëkryerje vjedhja e rëndë nga neni 327 par. 1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kurse i pandehuri i parë [REDAKTUAR] edhe për veprat penale dhe ate : 1. shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, 2. sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave

zyrtare nga neni 410 par.1 të KPRK-së dhe 3. rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.1 të KPRK-së, ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të cilat e përbëjnë figurën e veprave penale për të cilat akuzohen të akuzuarit.

Meqenëse të pandehurit e kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPRK-së, gjyqtari gjykues, konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, është bindur se mjaftueshm janë vërtetuar faktet , nuk ka prova të pa pranueshme të përcaktuara sipas nenit 257 të KPPRK-së, pa fjalë përfundimtare ka vazhduar me shqiptimin e dënimit ( *nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe Kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë dhe pa paraqitur fare fjalë përfundimtare, lidhur me këtë shih Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit, Gjykata vlerësoj rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 të KPRK-së dhe caktoi dënimin e paraparë nën kufijtë e minimumit ligjor të paraparë për këtë vepër penale të përcaktuar me dispozitat ligjore të nenit 75 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së dhe si rrethanë lehtësuese konform nenit 74 par.3 nënpar.3.3,3.10 të KPRK-së mori rrethanat personale dhe karakterin e të pandehurve, bashkëpunimi i të pandehurve në procedurën hetimore me organet e ndjekjes, pranimi i fajsisë, keqardhja e çfaqur, gjykata mori për bazë dhe atë se që në shqyrtimin fillestar gjyqësor e kanë pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e thellë dhe të singertë për veprat penale të kryera e që këto rrethana i ndërlidhi edhe me mosnjohjen e pasojave të kësaj vepre penale nga ana e të akuzuarve, gjendjen jo të mirë ekonomike, dhe personalitetin e të akuzuarve, rrethanat nën të cëlët e ka kryer veprën penale, sjellja e mëparëshme e të akuzuarve se nuk kanë qenë asnjëherë më parë të denuar për ndonjë vepër penale me aktgjykim të formës së prerë, ndërsa në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, poashtu edhe peshën dhe pasojat e kësaj vepre penale.

Për veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 327 par.1 të KPRK-së sanksioni penal është i paraparë me denim me gjobë burgimi në kohëzgjatje prej 3 vjetëve deri në 7 vjet, për vepër e dytë : shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së denimi sipas Kodit Penal është paraparë prej 1 deri në 8 vjetë burgim,për veprën e tretë: sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 410 par.1 të KPRK-së denimi sipas Kodit Penal është paraparë prej 3 muaj burgim deri në 3 vjetë burgim dhe vepra penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.1 të KPRK-së denimi sipas Kodit Penal është paraparë prej me gjobë ose deri në 3 vjetë burgim. Por, gjykata konform neni 75 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, pas pranimit të fajsisë nga ana e të akuzuarve dhe mendimin e prokurorit të shtetit e mbrojtësve të të akuzuarve, Gjykata të akuzuarit për veprat penale në kuptim të neni 43 par.1.2 të KPRK-së, i ka shqiptuar denimin me burg nën minimumin e paraparë ligjorë dhe ate të pandehurit të parë [REDAKTUAR] denimin unik 4 vite burgim dhe 1.000 euro gjobë, ndërsa të pandehurit të dytë [REDAKTUAR] i shqipton gjobën prej 1.000 euro dhe denimi me burgim në kohëzgjatje prej 2 vjet e 6 muaj burgim , ashtu që konform neni 76 par.1 nënpar.5 të KPRK-së e ka zbutur denimin për dy të pandehurit duke iu shqiptuar kështu të akuzuarve denim më të butë se minimumi ligjor i paraparë me Kod Penal. Kështu , konform neni 45 e 46 të KPRK-së, të akuzuarit dhe ate:

Të akuzuarin e parë: [REDAKTUAR]

Për pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi për veprën penale në bashkëkryerje me të të pandehurin [REDAKTUAR] dhe ate vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 nënpar.1.1 të KPRK-së, DENOHET

Me denim me gjobë në lartësi prej 1.000 euro (me shkronja:një mijë euro), si dhe denimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim, i cili do të ekzekutohet nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

Për pikën II. pika 1. të dispozitivit të këtij aktgjykimi për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së DENOHET :

Me denim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet burgim, i cili do të ekzekutohet nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

Për pikën II, pika 2. të dispozitivit të këtij aktgjykimi sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par.1 të KPRK-së, DENOHET:

Me denim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj burgim, i cili do të ekzekutohet nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

Për pikën II, pika 3. të dispozitivit të këtij aktgjykimi rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.1 të KPRK-së, DENOHET :

Me denim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj burgim, i cili do të ekzekutohet nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 80 të KPRK-së, të pandehurit të parë [REDAKTUAR] i shqiptohet DENIMI UNIK dhe ate DENIMI ME BURG në kohëzgjatje prej 4 vjet burgim dhe DENIMI ME GJOBË në shumën prej 1.000 euro (me shkronja: një mijë euro).

Në denimin e shqiptuar konform nenit 83 të KPRK-së i llogaritet edhe koha e kaluar në parapurgim prej datës 03.01.2018 deri më 22.03.2018.

Nëse dënimi me gjobë pjesa denuese prej 1.000 euro nuk mund të ekzekutohet asë në mënyrat tjera të parapara nga neni 46 par.3 të KPRK-së, gjykata do ta ekzekutoj aktgjykimin në atë mënyrë që i pandehuri për çdo 20 € të gjobës të vuaj një ditë burgu.

Të akuzuarin e dytë: [REDAKTUAR]

Për pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi për veprën penale në bashkëkryerje me të të pandehurin [REDAKTUAR] dhe ate vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 nënpar.1.1 të KPRK-së DENOHET:

Me denim me gjobë në lartësi prej 1.000 euro (me shkronja: një mijë euro), si dhe denimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim, i cili do të ekzekutohet nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykim.

Në denimin e shqiptuar konform nenit 83 të KPPRK-së, të akuzuarve iu llogaritet edhe koha e kaluar në parapurgim prej datës 03.01.2018 e deri më datën 22.03.2018.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve të paraparë në nenin 41 të KPRK-së përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm dhe në proporcion me peshën e veprës penale dhe pasojave të saja, në përshtatje me rrethanat e kryerjes së veprës penale, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi ndëshkimor që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konform nenit 463 par.2 të KPPRK-së e dëmtuarit: 1. [REDAKTUAR] 2. [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] që të dy zyrtar policor në Stacionin e Policisë në Ferizaj, 3. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Kaçanikut, 4. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, 5. [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr. 6. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, 7. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Kaçanikut, 8. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, 9. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, 10. [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR]” pa nr. dhe 11. [REDAKTUAR] Ferizaji, Rruga “ [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesë pasurore-juridike kompensimi i dëmit udhëzohen në kontest civil.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPRK-së, Të pandehurit 1. [REDAKTUAR] dhe 2. [REDAKTUAR], obligohen secili veq e veq që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë

shumën prej nga 30 € , kurse i pandehuri i parë [REDAKTUAR] edhe shpenzimet e procedurës penale në lartësi prej 20 eurove në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin të përmbarrimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohen të akuzuarit secili veq e veq që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguajnë shumën prej nga 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJKYATA THEMELORE NË FERIZAJ

P nr. 279/18 të dt.22.03.2018

Zyrtari ligjor

Gazmend Bytyqi

Gjyqtari

Elmaz Zenuni


#### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa

Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 dite

nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Ankesa dorëzohet nëpërmes kësaj gjykate.



Nga një kopje e aktgjykimit u dërgohet të dëmtuarve dhe atë: 1. [REDAKTUAR], 2. [REDAKTUAR] që të dy zyrtar policor në Stacionin e Policisë në Ferizaj, 3. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Kaçanikut, 4. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, 5. [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr. 6. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, 7. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Kaçanikut, 8. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, 9. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, 10. [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr. dhe 11. [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR]